



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LEDINA A. MALAJ
ADRESA NR.2, BLV"ZHAN DARK",
NR.1, NR.11
TEL: 692557874

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 3678

Nr. koleksioni: 1073

Tirane më 22/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020052750097595274

DATE 22/12/2020
NR REP 3678
NR KOL 1073



**LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE**

Sot, më datë 22.12.2020 , para meje Notere LEDINA A. MALAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, BLV"ZHAN DARK", NR.1, NR.11, u paraqit personalisht:

KËRKUES:

Illir Rula, atësia Thanas, amësia Liljana, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Hamdi Garunja 03910049; Nd. 21; H. 1; Ap. 12; Farkë; Sauk; 1044; Tiranë, lindur më 29/11/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034049701 dhe nr. personal I51129045B , .

OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Thanas Dhimitër Rula

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noterja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Notere LEDINA A. MALAJ, me zyrë Noterie në Tirane, NR.2, BLV"ZHAN DARK", NR.1, NR.11, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Z.Illir Rula me eshte drejtuar me një kërkesë, me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin, babain e tij, te ndjerin **Thanas Rula**.

Kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, pasi eshte trashegimtare ligjore i te ndjerit. **Sipas nenit 348 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise:** "Cilesia si trashegimtare dhe pjeset takuese ne trashegim caktohen ne deshmine e trashegimise leshuar nga Noteri, pas paraqitjes se certifikates se vdekjes se trashegimlensesit, sipas rregullave te caktuara ne kete Kod dhe ne ligjin per Noterine. **Deshmia e trashegimise ligjore leshohet nga Noteri i njesise vendore, ku ka pasur vendbanimin e fundit trashegimlensesi..."**

Kerkuesi ka paraqitur certifikaten e vdekjes, per te ndjerin **Thanas Rula**, i biri i Dhimitër dhe Vasilika , i datelindjes 16.01.1954 lindur ne Korçë ,sipas së cilës vërtetohet se i ndjeri ka ndërruar jetë me date 03.12.2020, pra mund te leshohet per te nje deshmi trashegimie. Per leshimin e deshmise se



trashegimnise per trashegimlensesin, kompetente eshte Dhoma e Noterise Tirane, pasi vendbanimi i fundit i tij ka qene ne Tiranë , Njesia Administrative nr.5, Zyra e Gjendjes Civile 377, vërtetuar sipas çertifikatës se vdekjes me datë 10.12.2020, lëshuar nga Njësia Administrative nr.5 Zyra e Gjendjes Civile 377.

Sipas Nenit 317 të Kodit Civil parashikohet se, trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament. Në rastin në shqyrtim, duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur prej Kerkuesit dhe verifikimeve të bera prej meje, Noteres prane Regjistrat Kombetar të Testamenteve, rezultoi se trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, kështu që për të përcaktuar personat që thirren në trashëgim dhe pjesët takuese të tyre **do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi Trashëgiminë Ligjore Nenet 360 – 371. Sipas Nenit 361 të Kodit Civil**, "... në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij... Vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparshme thirren në trashëgim ata të radhës pasardhëse..."

Duke iu referuar çertifikatës së vdekjes së trashëgimlensesit lëshuar nga Njesia Administrative nr.5 , Zyra e Gjendjes Civile 377, rezulton se i ndjeri ka vdekur në date 03.12.2020.

Duke iu referuar çertifikatës së përbërjes familjare, marre sipas regjistrat themeltar të vitit 1974, dhe prej Zyra e Gjendjes Civile Elbasan 095, me date 10.12.2020, dhe çertifikatave personale të cdo trashëgimtari, rezulton që trashëgimlensesi të ketë lënë këta trashëgimtarë si vijon:

- **Endri Rula**- i biri , i datelindjes 14.03.1982 ,lindur ne Elbasan sipas çertifikates personale leshuar prej Zyres se Gjendjes Civile 391 , Njesia Administrative Farkë, me numer personal I20314059M.
- **Ilir Rula**- i biri, i datelindjes 29.11.1985, lindur ne Elbasan sipas çertifikates personale leshuar prej Zyres se Gjendjes Civile 391, Njesia administrative Farkë , me numer personal I51129045B.

Rezulton se Bashkeshortja e të ndjerit Thanas Rula, Zonja Teuta Rula e datëlindjes 03.08.1958, ka nderruar jetë me date 13.11.2020 pra ka vdekur para trashëgimlensesit Thanas Rula dhe si e tille bazuar ne nenin 320 të Kodit Civil nuk e trashëgon të ndjerin Thanas Rula.

Keta trashëgimtarë ligjore (**Endri Rula dhe Ilir Rula**), janë të zotë për të trashëguar, pasi kanë qene gjalle ne kohen e çeljes se dëshmisë së trashëgimisë, pra datën e vdekjes se trashëgimlënësit, si dhe nuk kanë asnjë shkak për përjashtimin nga trashëgimia, nuk janë deklaruar të padenjë për të trashëguar dhe as kanë hequr dore nga trashëgimia.

Sipas nenin 361/1 të Kodit Civil, "fëmijet" si trashëgimtarë ligjore të rradhës së parë, trashëgojnë secili në pjesë të barabarta, në rastin në shqyrtim secili nga 1/2 pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme e të paluajtshme dhe po me këto pjesë përgjigjen edhe për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, por jo me shume se vlera e asaj që përfitojnë.

Nga sa u parashtrua me larte, une Noterja Ledina Malaj, pasi shqyrtova gjithe dokumentacionin e



paraqitur nga kerkuesi dhe ne baze te nenit 348 te Kodit Civil, si dhe Ligjit per noterine:

Leshoj kete deshmi trashegimie per trashegimlensesin, te ndjerin Thanas Dhimtë Rula duke percaktuar si trashegimtare, si dhe pjeset takuese ne trashegimi si me poshte:

Endri Rula- i biri, i cili trashegon 1/2 e pasurise trashegimore te trashegimlensesit Thanas Dhimitër Rula.

Ilir Rula - i biri, i cili trashegon 1/2 e pasurise trashegimore te trashegimlensesit Thanas Dhimitër Rula.

Ne te njejtin raport me perfitimet nga pasuria trashegimore rendojne edhe detyrimet mbi secilin trashegimtare.

Brenda nje afati 30 ditor nga dita e leshimit te aktit noterial trashegimtaret duhet te aplikojne per regjistrimin e pasurive te paluajtshme prane ASHKadaster.

Tirane me date 22.12.2020



NOTERE

LEDINA MALAJ

